



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:181432

Datë: 28.04.2022

Numri i dokumentit: 02964894

P.nr.36/22

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtarja Raima Elezi si kryetare e trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Kujtesa Uka, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.T. nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.108/21 të dt.24.02.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të Shtetit M. S, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, avokatit B.H nga Prizreni, me datë 26.04.2022, publikisht morri dhe shpalli këtë

A K T G J Y K I M

I akuzuari

A.T., nga i ati B. e ëma G. e vajzërisë K. i lindur më dt...., në Prizren, ku edhe jeton në rr. i gjendjes së dobët ekonomike, i papunë, i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim prej dt. 02.02.2022, deri më 26.04.2022.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë dhe muaj të pavërtetuar gjatë vitit 2020-2021, disa herë në vazhdimësi, pa autorizim ka blerë ose ka poseduar në sasi të ndryshme, me qëllim të shitjes ose ofrimit për shitje, substancën narkotike të llojit marihuanë, e cila është shpallur me ligj si narkotik, personave të ndryshëm në Prizren, me të cilët është takuar në lagjen e tij ku jeton dhe ka komunikuar në mënyra të ndryshme, në mesin e tyre me personin B.B, me të cilin ka komunikuar në rrjetin social "Facebook" dhe të njëjtit i ka ofruar për shitje substancë narkotike, ndërsa më 01.02.2022, me rastin e ekzekutimit të urdhër kontrollit nga Njësi për Hetimin e Trafikimit me Narkotike në Prizren, në shtëpinë e tij te banimit, që gjendet në rrugën "Rozafa", nr. 3, është gjetur një qese plastike e mbushur me substancë narkotike të llojit marihuanë, me peshe 13.20 gram.

- Kësodore ka kryer veprën penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK.

Andaj gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 21, 38, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72, 79 KPRK dhe 282 KPP dhe neneve të përmendur më lartë, e

G J Y K O N

- **me dënim me gjobë në shumë prej 400€ (katërqind euro)**, të cilin dënim është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe

- **me dënim me burg në kohë zgjatje prej 7 (shtatë) muaj**, në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 02.02.2022 deri me dt.26.04.2022.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguajë dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do ta caktojë një ditë burg.

U R D H Ë R

Në bazë të nenit 282 par. 1 lidhur me par. 2 nën par. 2.2 të KPP substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 13.20 gr. i nënshtrohet automatikisht konfiskimit meqenëse është qenësish e rrezikshme dhe e paligjshme.

Obligohet i akuzuari që të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës sipas llogarisë së gjykatës ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 € dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumë prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda ka ngritur aktakuzën PP/L.nr.180/21 të dt. 24.02.2022, kundër të akuzuarit A.T nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK.

Pas pranimit të shkresave të lëndës kryetarja e trupit gjykues ka caktuar shqyrtimin fillestar për datën 26.04.2022, ku i akuzuari A.T, pas udhëzimeve të dhëna nga kryetarja e trupit gjykues dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e vet, pasi ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit M.S nuk ka pasur vërejtje në deklaratën e të akuzuarit sa i përket pranimit të fajësisë. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi qëndron pranë aktakuzës ndaj të akuzuarit A.T nga Prizreni, për shkak të veprës penale nga neni 267 par. 1 te KPRK, meqenëse me provat e propozuara në aktakuzë është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si ne dispozitiv ashtu siç e ka pranuar edhe vet i akuzuari , kështu që kërkon nga gjykata që të akuzuarin ta shpallë fajtor për veprën penale nga neni 267 par.1 të KPRK dhe ta denjojë sipas ligjit. Me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata të ketë parasysh të gjitha rrethanat të cilat

ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, nga ato rënduese te ketë parasysh shkallen e rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale dhe vlerat te cilat duhet te mbrohen e që në shumicën e rasteve është jeta e te rinjve te cilit me konsumimin e substancës narkotike e rrezikojnë jetën dhe shëndetin e tyre, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata te ketë parasysh pranimin e fajësisë dhe si dënim plotësues propozon edhe konfiskimin e pastaj edhe shkatërrimin e substancës narkotike si objekti i aktakuzës.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.T, av. B.H në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i mbrojturi i tij pas konsultimit me të, me vullnetin e tij ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet. I propozon gjykatës që me rastin e shqiptimit te dënimit te ketë parasysh se i mbrojturi i tij vullnetarisht ka pranuar fajësinë, është penduar thellë për veprën penale të cilën e ka kryer, është hera e pare që ka rënë në konflikt me ligjin, është i moshës së re, i gjendjes së vështirë ekonomike dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të ndodhë që të kryejë vepër tjetër penale. I propozon gjykatës që sipas nenit 72 par.1 pika 1.4 të KPRK, për shkak të rrethanave lehtësuese që i mbrojturi i tij ia ka krijuar vetes, të bëjë zbutjen e dënimit në kufijtë e dispozitës ligjore të cekur më lartë.

I akuzuari A.T, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i mbështet fjalët e mbrojtësit të tij duke shtuar se pendohet thellë për gabimin e bërë, premtion se në të ardhmen nuk do të vijë në konflikt me ligjin, është i gjendjes së varfër ekonomike, jeton në familje prej gjashtë anëtareve ku babai punon në një shkollë si sigurim me një rrogë të vogël prej 200 euro, e herë pas here edhe vet punon punë private.

Në bazë të pranimit të fajësisë së të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës është vërtetuar kjo gjendje faktike:

me datë dhe muaj të pavërtetuar gjatë vitit 2020-2021, disa here ne vazhdimësi, pa autorizim ka blerë ose ka poseduar ne sasi të ndryshme, e me qellim të shitjes ose ofrimit për shitje, substanca narkotike të llojit marihuanë, të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, personave të ndryshëm ne Prizren, me të cilët është takuar në lagjen e tij ku jeton dhe ka komunikuar në mënyra të ndryshme, në mesin e tyre me personin B.B, me të cilin ka komunikuar në rrjetin social “Facebook” dhe të njëjtit i ka ofruar për shitje substancë narkotike, ndërsa me datë 01.02.2022, me rastin e ekzekutimit të urdhër kontrollit, nga Njësi për Hetimin e Trafikimit me Narkotike, ne Prizren, në shtëpinë e tij te banimit, që gjendet në rrugën “Rozafa”, nr. 3, është gjetur një qese plastike e mbushur me substance narkotike e llojit marihuanë me peshe 13.20 gram.

Meqenëse në shqyrtimin e dytë i akuzuari vullnetarisht ka pranuar fajësinë dhe gjykata sipas detyrës zyrtare nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme dhe në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë, të cilin pranim e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe i cili pranim mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP dhe konsideron se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të cilin e shpalli fajtor dhe e gjykoj sipas ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të neneve 69, 70, 71 par 1 nën par. 1.3 dhe 72 të KPRK, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë rënduese

gjkata ka marr parasysh që secila prej këtyre rrethanave veç e veç janë vlerësuar në ndërlidhje me të gjitha rrethanat e tjera të cilat ndikojnë në matjen e dënimit, në rastin konkret duke gjetur si rrethanë rënduese shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikun shoqëror dhe shkallën e rrezikimit të vlerës së mbrojtur duke pasur parasysh se pasojat e veprës të cilat prekin në shëndetin e njerëzve, ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë se është penduar për veprimet e veta, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të vijë në konflikt me ligjin, gjendja ekonomike, e si rrethanë posaçërisht lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë, prandaj gjykata duke marrë për bazë edhe nenin 71 par 1 nën par 1.3 të KPRK, e ka dënuar si në dispozitiv të aktgjykimit duke konsideruar se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 të KPP.

Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike është marrë në bazë të nenit 282 par.1 dhe 2 pika 2.2 të KPP.

Vendimi mbi kompensimin në emër të Fondit për kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në bazë të nenit 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
PKr.nr.36/22 të datës 26.04.2022

Procesmbajtësja
Kujtesa Uka

Përkthyesja gjyqësor
Asnije Berisha

Kryetari i trupit gjykues
Raima Elezi

UDHËZIM JURIDIKË: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së aktgjykimit, nëpërmjet kësaj gjykate, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.